



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Z È D H È N È S I**

Tiranë, më 20/02/2015

*Njoftim për Shtyp*

**KLSH KALLËZON NË PROKURORI 3 SPECIALISTË TË ZYRËS VENDORE**  
**TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME SARANDË**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr. 673/1, datë 07.07.2014 dhe nr. 673/3, datë 03.10.2014, ka audituar Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, për periudhën nga Janar 2011 deri më Shtator 2014.

Nga auditimi, u konstatuan një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore, mbi bazën e të cilave KLSH ka kryer kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë, për 3 Specialistë të këtij institucioni, **A.N.** me detyrë ish-Juriste, **R.P.** me detyrë ish-Hartograf dhe **N.B.** me detyrë ish-Hartograf, për konsumim të elementëve të veprës penale të “*Shpërdorimit të detyrës*”, neni 248 i Kodit Penal, pasi kanë kryer:

**Shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore lidhur me zbatimin e tyre në pranimin, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, duke sjellë për pasojë aplikimin dhe regjistrimin e 31 pasurive të përfituara me Leje Legalizimi, në zonën turistike të Ksamilit, brenda brezit turistik, ku ndalohej zhvillimi i ndërtimit dhe nuk lejohet legalizimi i objekteve e blerja e truallit, në 9 raste shmangie të detyrimeve financiare prej 6.2 milion lekë, në 150 raste për sipërfaqen prej 23 Ha ka regjistruar tokë bujqësore më tepër se titulli i pronësisë (AMTP) por dhe shkelje të tjera, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, shfuqizuar me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012, “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”, VKM nr. 438, datë 28.6.2006, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim”, ligjin nr. 10186, datë 05.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, Vendimin e KRRTRSH nr. 4, datë 18.12.2004 “Për brezin mbrojtës të vijës bregdetare jo më pak se 100 m<sup>2</sup>” etj.**

***Më konkretisht KLSH konstatoi:***

*Në 18 raste në Zonën Turistike të Ksamilit janë pranuar për aplikim, regjistruar e pajisur me certifikatë pronësie, personat përfitues të lejeve të legalizimit, kur trojet e zëna dhe objektet e ngritura mbi to, nuk plotësojnë kushtet për legalizim, pasi ndodhen brenda “Brezit mbrojtës të vijës Bregdetare i cili është jo më pak se 100 metër nga vija e ujit”, madje në afërsi të bregut të detit.*

*Për trojet dhe objektet e legalizuara të ndodhura brenda këtij brezi, nuk mund të veprojej*

pa u përcaktuar më parë zona e stimuluar, për veprimtari të stimuluar dhe që kryhen nga persona të stimuluar, procedurë e cila nuk kryhet nga ALUIZNI apo ZVRPP.

Në 9 raste në Zonën Turistike të Ksamilit, janë pranuar për aplikim, regjistruar e pajisur me certifikatë pronësie, personat përfitues të lejeve të legalizimit, procedurë, zbatimi i të cilës përveç regjistrimit në kundërshtim me ligjin ka krijuar dhe një dëm ekonomik **prej 6.2 milion lekë**, rezultat i mos zbatimit të çmimit të tregut sipas VKM nr. 139, datë 22.02.2012, *pasi personave të cilëve u është legalizuar objekti e shitur trualli* nuk janë persona të stimuluar, në zona të stimuluar dhe me aktivitet veprimtari të stimuluar.

Në 146 raste për një sipërfaqe toke prej **16.6 Ha** e llojit “arë” të ndodhur në zonën kadastrale nr. 3846, Xarrë, ZVRPP Sarandë në regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e certifikatave të pronësisë, nuk ka vepruar me identifikimin, veçimin dhe regjistrimin në pronësi “shtet”, të pasurisë të regjistruara më tepër se Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi, por ka lejuar që familjet fermere të pajisen me dokument pronësie sipas sipërfaqes faktike në terren, si dhe të pa fituara nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, veprime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.4.2009 dhe UKM nr. 3, datë 13.6.2013, “Për mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë e Paluajtshme të Fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”.

Në 24 raste për një sipërfaqe toke prej **6.5 Ha** e llojit “arë” të ndodhur në zonën kadastrale nr. 1253, Borsh, ZVRPP Sarandë në regjistrimin e pasurive dhe lëshimin e certifikatave të pronësisë, nuk ka vepruar me identifikimin, veçimin dhe regjistrimin në pronësi “shtet”, të pasurisë të regjistruara më tepër se Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi, por ka lejuar që familjet fermere të pajisen me dokument pronësie sipas sipërfaqes faktike në terren, si dhe të pa fituara nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, veprime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.4.2009 dhe UKM nr. 3, datë 13.6.2013.

Në 1 rast në zonën kadastrale nr. 8642, Qyteti Sarandë, ZVRPP Sarandë ka kryer regjistrimin e një trualli me sipërfaqe 680 m<sup>2</sup> dhe të objektit “Godinë banimi + garazhe 8 kate me sipërfaqe njolle ndërtimi prej 470 m<sup>2</sup>”, me mungesë në dokumentacionin e përfitimit të pronësisë mbi truallin, si dhe kur objekti shumëkatësh ndodhet në zonën e “Turizëm-Kanali i Çukës”, zonë në të cilën nuk lejohet regjistrimi i ndërtimeve mbi 3 kate, pasi vjen në kundërshtim me vendimin e KRRTRSH nr. 3, datë 19.02.1999, i cili ka përcaktuar se numri maksimal i kateve për objektet e ndërtuara në këtë zonë është 2-3 kate.

Në 1 rast në zonën kadastrale nr. 8642, Qyteti Sarandë, ZVRPP Sarandë ka kryer regjistrimin e një trualli të njohur e kthyer me vendim të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke regjistruar më tepër një sipërfaqe të pa përfitur sipas vendimit, dhe tjetërsim të padrejtë të sipërfaqes prej **1.25 Ha** tokë të llojit truall (ka regjistruar sipërfaqen prej 69.2 Ha nga 68 Ha sipërfaqe e kthyer sipas vendimit), si dhe kur prona e regjistruar krijon pjesërisht mbivendosje me pasuri të regjistruara më parë, për sipërfaqen prej 8 Ha.

Mbështetur sa më sipër, KLSH me shkresën nr. 673/7, datë 30.01.2015 ka kryer kallëzim penal për shpërdorim detyre duke i përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse **për ish Specialistët e ZVRPP Sarandë, A.N.** ish-Juriste, **R.P.** ish-Hartograf dhe **N.B.** ish-Hartograf, të cilët në mos përmbushje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave ligjore, kanë konsumuar elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.